

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **K.R.U. MITROVICA SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KURM-26-5352-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim dhe montim të sistemit të sigurimit nëpër Stacione të Pompimit dhe Rezervuar (Instalimi I sistemit të Kamerave dhe vendosja e rrethojave për këto Objekte)**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	PROFESSIONAL ALARM L.L.C.
NUI	810321498
Adresa	ENVER MALOKU, 108
Vendi	PRISHTINË
Kodi postar	10 000
Numri Telefonit	+383 44964554
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Tafë Blakaj
Adresa elektronike	info@professionalalarm.eu
Data e parashtrimit të ankesës	25.08.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim dhe montim të sistemit të sigurimit nëpër Stacione të Pompimit dhe Rezervuar (Instalimi I sistemit të Kamerave dhe vendosja e rrethojave për këto Objekte)

B05 Njoftim per Kontrat - 03.07.2026

Kërkesë për sqarimin e tenderit - 31.07.2026

Përgjigje nga AK - 06.08.2026

Afati i fundit per dorezimin e tenderit - 18.08.2026 ora 14:00

KËRKESË PËR RISHQYRTIM - 12.08.2026

Vendimi i AK lidhur me kerkesen per Ri-shqyrtim - 14.08.2026

Ankesa OSHP - 25.08.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

KËRKESË PËR RISHQYRTIM - 12.08.2026

Vendimi i AK lidhur me kerkesen per Ri-shqyrtim - 14.08.2026

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ne konsiderojmë se si Autoriteti Kontraktues (AK), K.R.U. MITROVICA SH.A. , për këtë procedurë të prokurimit ka shkelur dispozitat ligjore të LPP-së:

Nenin 1 Qëllimi

Nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 27 Dosja e Tenderit

Neni 28 Specifikimet teknike

Neni 53 Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit

Si dhe nuk ka vepruar në përputhje me Rregulloren nr. 001.2022 për Prokurimin Publik konkretisht në nenet si në vijim:

Neni 17 Dosja e Tenderit

Neni 19 Specifikimet Teknike

Neni 27 Kriteret e Dhënies së Kontratë

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues (AK) nuk ka vepruar në përputhje me nenin 1,7, 27, 28 dhe 53 të LPP-së si dhe me Rregulloren nr. 001.2022 për Prokurimin Publik konkretisht në nenet 4, 17, 19 dhe 27.

Pretendimi ankimor 1: Autoriteti Kontraktues (AK), KRU Mitrovica ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 dhe 28 të LPP-së, si dhe Nenin 19 të Rregullores Nr. 001/2022

për Prokurimin Publik

Fakti 1 - AK nuk ka qenë fare transparent sa i përket kësaj procedurë të prokurimit dhe nuk ka trajtuar barabartë të gjithë Operatorët Ekonomik. Kjo është e vërtetuar edhe me përgjigjet të cilat i kemi pranuar pas kërkesës tonë për informata shtesë dhe pas Kërkeses për ri-shqyrtim. Në dosje të tenderit për pozicionin "Sistemi inteligjent i furnizimit me energji solare", kërkesat teknike përfshin karakteristika që perputhen plotësisht me VIGI SP18090 (<https://www.vigi.com/my/business-networking/vigi-solar-power-system/vigi-sp18090/>).

Në veçanti, kombinimi i kërkesave si: panele fotovoltaike me fuqi minimale 180 W; bateri litium me kapacitet minimal 93 Ah; funksion inteligjent të ngrohjes së baterisë; menaxhim lokal përmes LAN; remote reboot dhe remote reset; push notifications; përditësim firmware në distancë; monitorim në kohë reale i statusit të ngarkesës dhe statistikave të konsumit të energjisë; tre dalje DC me konfigurim specifik; konstruksion për shtylla me diametër 80–160 mm, krijon një kombinim që kufizon ndjeshëm numrin e operatorëve ekonomikë dhe prodhuesve që mund të ofrojnë një zgjidhje në përputhje me kërkesat.

- Është kërkuar **MAF** (Autorizim të dedikuar për këtë projekt për shitje si dhe garancionin minimum 24 muaj nga prodhuesi për Setin e kamerës dhe Softuerit për Menaxhimin Qendror të Sistemit të Mbikëqyrjes.), ndërsa në anën tjetër keni specifikuar pajisje të cilat i përshtaten vetëm prodhuesit TPlink Kërkesë diskriminuese me të vetmin qëllim eliminimin e konkurrencës për arsye se të favorizimit të drejtperdrejt të OE të cilit i janë përshtatur edhe specifikimet teknike edhe kriteret tjera diskriminuese.

VIGI SP18090 End of Life

VIGI Intelligent Solar Power Supply System



- 2x 90W Photovoltaic Panels and 93.6Ah/10.95V Lithium Battery
- 3x DC Voltage Output Ports
- Modular Design (Composed of 2x Solar Panel + 1x Solar Mount + 1x System Controller)
- 5°/15°/25°/35°/45°/55° Adjustable Angles
- Independent Protection Circuit
- Intelligent Auxiliary Heating Technology
- Maximum Power Point Tracking (MPPT) Charging Controller
- IP66 Weatherproof
- Remote Management and Simple Installation

[Learn more about VIGI solar power solution>](#)

[Start customizing your solar power security system >>](#)

Note: This virtual kit requires the purchase of 1x VIGI PS90, 2x VIGI Solar Power 90W units, and 1x VIGI 180W Solar

Mount for full functionality

Pretendimi ankimor 2:

Siç dëshmohej edhe në kërkesën për sqarim të tenderit, si Autoritet Kontraktues, KRU Mitrovica ka vepruar në kundërshtim me nenin 28, paragrafin 2 të LPP-së si dhe paragrafin 17.17 dhe 19.4 të Rregullores nr. 001.2022 për Prokurimin Publik .

AK ka përpiluar specifikime teknike që favorizojnë vetëm një prodhues.

Pozicioni nr.2 ne dokumentit karakteristikat teknike- për Outdoor 4G Gateway/Router përmbajnë një kombinim specifik kërkesash (LTE Cat 6, Wi-Fi 6, PoE In, 2xPoE Out, SD-WAN, platformë SDN, automatic device discovery, unified configuration, WireGuard,

SSL VPN, etj.), të cilat kufizojnë konkurrencën dhe të favorizojnë prodhues.

Bazuar ne kërkesën teknike vërehet qarte qe produkti i sipërpërmendur është modeli ER703WP-4G-Outdoor i cili plotëson 100% te specifikimit te kërkuar me lart. Dëshmi: Datasheet nga prodhuesi per krahasim <https://www.omadanetworks.com/my/business-networking/omada-router-4g-wifi-router/er703wp-4g-outdoor/>



ER703WP-4G-C

Omada 4G+ Cat6 A)

- 4G+ Cat6 up to 300
- AX3000 Wi-Fi 6 with
- 3 × Gigabit WAN/LAN
- 1 × Nano SIM Card S
- 802.3at/bt PoE or 12
- 4G and Ethernet W/
- IPSec/L2TP/PPTP/C
- Centralized Manage
- IP55 Weatherproofi

[Learn more about Omada](#)



Pretendimi ankimor 3:

Për Pozicionin 3, vërehet se kombinimi i karakteristikave të përcaktuara përputhet në mënyrë të konsiderueshme me specifikimet e një modeli specifik të prodhuesit TP-Link VIGI, konkretisht modelit InSight PTZ5425 <https://www.vigi.com/sg/business-networking/vigi-network-camera/insight-ptz5425/>

, i cili përmbush në tërësi kërkesat e listuara në dosjen e tenderit dhe kete mund te vertetoni edhe ne linkun e prodhuesit nese i beni krahasimet.

TP-Link e dokumenton konkretisht 25X optical zoom, 16X digital zoom, 360° pan, -20°/ 90° tilt, 300 presets, 100 m IR, 50 m white light dhe 16 Mbps bitrate.

Bazuar ne kërkesën teknike vërehet qarte qe produkti i sipërpërmendur është modelit InSight PTZ5425 i cili plotëson 100% te specifikimit te kërkuar.



InSight PTZ5425

VIGI 5-inch 4MP 25X Fu

- 360° Wide-Area Coverag
- 25X Optical Zoom & 16X
- Intelligent Auto Tracking
- Up to 240°/S Pan Speed
- Red & Blue Flashing Ligh
- People & Vehicle Attribut
- Human & Vehicle Classif
- Smart Detection
- Smart Video Enhancem
- Audio and Alarm Interfac
- IP66 Weatherproof / K0€
- Digital Defog / Built-in Le
- H.265+ Compression Te

Pretendimi ankimor 4:

Pozicioni nr.4 - Konstatojme se kombinimi i parametrave të përcaktuar në dosjen e tenderit korrespondon në mënyrë identike me produktin TP-Link VIGI InSight S385DPS

<https://www.vigi.com/us/business-networking/vigi-network-camera/insight-s385dps/>

Në formën aktuale, kërkesat rezultojnë në kufizim artificial të konkurrencës dhe në favorizim të operatorëve ekonomikë që disponojnë ose përfaqësojnë produktin e synuar.

5456×1520 180°/51° Dual F1.0 50m IR 50m White Light 120dB WDR Red/Blue lights
Loitering Abnormal Sound Scene Change Human/Vehicle Classification Alarm I/O Audio
I/O 512GB IK10 -30/ 60°C.

TP-Link e përshkruan S385DPS pikërisht si “8MP Outdoor ColorPro Panoramic Bullet Network Camera”, me Dual-Lens 180° Panorama, ndërsa specifikimi e përshkruan pikërisht si kamerë panoramike 180° për lokacion solar.

Duhet theksuar që jo vetëm pozicionet e cekuar më lartë i janë përshtatur prodhuesit TPlink por ka edhe produkte tjera që i janë përshtatur po të njëjti prodhues i cili është një prodhues i vecant dhe është e pamundur që keto specifika të plotësohen me prodhues tjerë dhe kështu ju keni diskriminuar të gjithë prodhuesit tjerë dhe rrjedhimisht edhe OE që merren me sisteme të sigurisë dhe që operojnë në Kosovë.

Duhet edhe një gjë ta keni parasysh që asnjë OE nuk mund të ofrojë zgjidhje ekuivalente sepse në rastin konkret nuk ka ekuivalence, kjo duke pas parasysh se specifikacioni teknik i është përshtatë 100% vetëm prodhuesit TPlink.

Autoriteti Kontraktues, në përgjigjen e tij, përmend disa prodhues si Milesight, Uniview (UNV), Invidtech, Victron Energy, Schneider Electric, Siemens, Mean Well, Hanwha Vision dhe Tiandy, duke deklaruar se ekzistojnë prodhues të ndryshëm që mund të ofrojnë zgjidhje të tilla.

Mirëpo, nuk është identifikuar asnjë model konkret i ndonjërit prej këtyre prodhuesve dhe nuk është paraqitur asnjë dokumentacion teknik që dëshmon se një produkt konkret i këtyre prodhuesve i përmbush të gjitha kërkesat teknike të përcaktuara në specifikim, në mënyrë kumulative.

Për të vërtetuar se specifikimi nuk kufizon konkurrencën, do të duhej të identifikoheshin konkretisht së paku disa produkte/modele alternative dhe të tregohej, për secilin prej tyre, se si përmbushen të gjitha kërkesat teknike të specifikuara.

Në të kundërtën, vetëm listimi i emrave të prodhuesve nuk është i mjaftueshëm, pasi fakti që një prodhues ofron sisteme energjetike solare, UPS, inverterë, kontrollues apo pajisje të tjera të ngjashme nuk nënkupton automatikisht se ai prodhues ofron një sistem të integruar që përmbush të gjitha kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues.

Duke pasur parasysh se përgjigja e dhënë nuk ofron prova konkrete për ekzistencën e alternativave që përmbushin të gjitha kërkesat teknike në mënyrë kumulative, konsiderojmë se shqetësimi i ngritur në Kërkesën për Sqarime dhe Kërkesën për Ri-Shqyrtim ka mbetur i paadresuar.

Pretendimi Ankimor 5 - Sa i perketë Vendimit Lidhur me kërkesën për Ri-Shqyrtim nga AK te dt.14.08.2026 - Argumenti i AK-së për “produkte ekuivalente” nuk e zgjidh problemin

Rregullorja Nr. 001/2022 është shumë e qartë: specifikimet teknike duhet të jenë jo-diskriminuese dhe të mos paraqesin kufizime të paarsyeshme të konkurrencës. Neni 19.3 kërkon karakteristika të përcaktuara në mënyrë jo-diskriminuese, ndërsa neni 19.4 kërkon që përshkrimi të jetë i qartë, i saktë dhe preciz dhe të mos krijojë kufizime të paarsyeshme të konkurrencës.

Madje, neni 19.6 përcakton se referenca ndaj një prodhimi, burimi, marke, lloji ose origjinë specifike është, si rregull, e ndaluar, përveç rasteve të veçanta dhe atëherë duhet të shoqërohet me “ose e barasvlershme/ekuivalente”.

Pra, fakti që AK ka shkruar ose ka pranuar “ekuivalent” nuk do të thotë automatikisht se specifikimi është ligjor. “Ekuivalenti” duhet të ketë mundësi reale të konkurrojë. Nuk mjafton që teorikisht të thuhet se “mund të ofrohet produkt ekuivalent”, ndërkohë që **kombinimi i kërkesave është ndërtuar në mënyrë të tillë që vetëm një model konkret i tregut i përmbush të gjitha.**

Pretendimi Ankimor 6 - AK duhet ta përgjigjet pyetjes konkrete: cili është modeli alternativ?

Ne kemi dhënë:

- TP-Link VIGI SP18090 për sistemin solar;
- TP-Link ER703WP-4G-Outdoor për routerin;
- TP-Link VIGI InSight PTZ5425 për PTZ;
- TP-Link VIGI InSight S385DPS për kamerën panoramike;

dhe kemi argumentuar se parametrat e tenderit përputhen në mënyrë shumë të detajuar me këto produkte.

Në përgjigje, AK ka përmendur Milesight, Uniview, Invidtech, Victron Energy, Schneider Electric, Siemens, Mean Well, Hanwha Vision dhe Tiandy, por nuk ka identifikuar një

model konkret dhe nuk ka bërë krahasim teknik .

Pretendimi Ankimor 7 - Neni 28.2 i LPP-së përcakton se specifikimet teknike duhet të hartohen në mënyrë që të jenë në përputhje me objektin e prokurimit dhe të drejtohen drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar dhe tenderuesit.

Pyetja është:

A është specifikimi i hartuar në mënyrë të tillë që realisht të lejojë qasje të mjaftueshme të operatorëve ekonomikë?

Nëse një kombinim shumë specifik parametrash e bën praktikisht të mundur vetëm një produkt, atëherë formulimi “ose ekuivalent” nuk e eliminon vetvetiu problemin., por e eliminon konkurrencen.

Pretendimi Ankimor 8 – Kërkesa nr.4. OE duhet duhen të dorëzojnë Autorizim te dedikuar per kete projekt për shitje si dhe garancionin minimum 24 muaj nga prodhuesi për Setin e kamerës dhe Softuerit për Menaxhimin Qendror të Sistemit të Mbikëqyrjes.

Qëllimi i deklaruar mund të jetë legjitim, por duhet të vlerësohet edhe efekti real i kësaj kërkesë mbi konkurrencën.

Sepse nëse:

1. specifikimet teknike janë përshtatur me një prodhues të caktuar;
2. kërkohet MAF i dedikuar për **këtë projekt**;
3. MAF përmban edhe detyrim për garanci 24 muaj;
4. MAF mund të lëshohet vetëm për një OE atëherë kombinimi i këtyre kërkesave mund të rezultojë në një **barrierë praktike për pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë**, edhe pse AK thotë se pranohen produkte ekuivalente.

Për këtë arsye, kërkojmë që ky pretendim të shqyrtohet jo vetëm në aspektin formal të qëllimit të MAF-it, por në aspektin e efektit të tij real mbi konkurrencën dhe pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë.

PËRFUNDIM:

Ne si pale interesi, bazuar në ato që kemi cekur më sipër, konsiderojmë se ekzistojnë baza

të mjaftueshme ligjore, fakte materiale lidhur me kërkesat për të konstatuar se specifikimet teknike nuk janë në pajtim me parimet e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe konkurrencës së drejtë, si dhe me kërkesat për specifikime teknike jo-diskriminuese dhe pa kufizime të paarsyeshme të konkurrencës, kështu që kërkojmë nga OSHP që ankesën tonë ta aprovoj si të bazuar dhe të udhëzoj AK-se që të beje anulimin e këtij aktiviteti prokurimit dhe ta ri-tenderojë me specifikime dhe kritere të cilat u japin hapsirë për pjesmarrje në këtë aktivitet të prokurimit edhe OE tjerë dhe të dorëzojnë oferta të përgjegjshme ose ta urdhëroj AK-se që të modifikoj ose ndryshoj specifikimet teknike sepse me këto specifikime dhe me këto kritere si është tani mund të jete i përgjegjshëm vetëm një OE për të cilin ne mendojmë që i është pershtatur ky specifikim teknik.

Megjithatë, qëllimi ynë nuk është të shkaktojmë vonesa në zhvillimin e procedurës apo në implementimin e projektit. Përkundrazi, konsiderojmë se realizimi në kohë i këtij projekti është në interes të të gjitha palëve, përfshirë Autoritetin Kontraktues, dhe se shmangia e kontesteve dhe vonesave të panevojshme do të ishte në të mirë të vetë procesit të prokurimit dhe realizimit sa më efikas të projektit.

Për këtë arsye, kërkojmë që OSHP:

1. Të aprovojë ankesën si të bazuar;
2. Të konstatojë shkeljet e pretenduara të Nenit 7 dhe Nenit 28 të LPP-së dhe Nenit 19 të Rregullores Nr. 001/2022;
3. Të urdhërojë Autoritetin Kontraktues që të korrigjojë specifikimet teknike, duke mundësuar konkurrencë reale ndërmjet Operatorëve Ekonomikë dhe prodhuesve;
4. Të obligojë AK-në që, gjatë korrigjimit të specifikimeve, të përdorë kërkesa objektive të performancës dhe funksionalitetit, pa orientuar specifikimet drejt një prodhuesi ose modeli të caktuar;
5. Nëse OSHP vlerëson se shkeljet nuk mund të korrigjohen në mënyrë tjetër, të urdhërojë anulimin e aktivitetit dhe ri-tenderimin e tij me specifikime dhe kritere në pajtim me LPP-në dhe legjislacionin dytësor.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Si rezultat i këtyre specifikimeve teknike, ne nuk mund të paraqesim një ofertë të përgjegjshme dhe konkurruese, pavarësisht përvijes mbi 23 vite, kapaciteteve profesionale dhe teknike.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*